



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 442, datë 14 .09.2020

PËR
PËRFSHIRJEN E KANDIDATES ZNJ. {...}
NË PROCEDURAT E KOMANDIMIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates znj. {...} për komandimin në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në Vendimin e tij nr.400, datë 7.10.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Miratimin e opinionit për përfshirjen e kandidates znj.{...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në procedurat e komandimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR